

Plani i punës i Zyrës për Informim për vitin 2024

Zyra për Informim është një urë lidhëse ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve, që funksionon brenda pushtetit, por i merr parasysh interesat e të dyja palëve.

Për vitin 2024, Zyra ka planifikuar këto aktivitete:

- Do të përcjellë të gjitha aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal dhe kujdeset që t'i bëjë publike vendimet dhe qëndrimet e institucioneve komunale.
- Do të marrë pjesë në takimet e drejtpërdrejta të kryetarit të Komunës.
- Do të përcjellë mbledhjet e Kuvendit, Komiteteve obligative (KPF, K.KOM), KKSBB, MKKDHF.
- Do të koordinojë ndërlidhjen me media përkitazi me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e institucioneve komunale.
- Do t'i njoftojë mediat për të gjitha takimet publike dhe konferencat.
- Do të përgjigjet në kërkesat e mediave në lidhje me çështjet e Komunës.
- Do të mbajë kontakte me përfaqësues të mediave, shoqërinë civile dhe organizmat tjerë.
- Do të bëjë shoqërimin e përfaqësuesve të mediave brenda Komunës dhe regjistrin deklaratar e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të mediave.
- Do të ndërmjetësojë në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për media.
- Do të njoftojë rregullisht udhëheqjen komunale për marrëdhëniet me shtypin dhe reagimet eventuale të tyre ndaj aktiviteteve në Komunë.
- Do të mirëmbajë dhe azhurnojë webfaqen e Komunës.
- Do të bëjë publikimin e shpalljeve, konkurseve, njoftimeve dhe të gjitha informatave dhe publikimeve tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin.

Ky plan përfshinë veprime që promovojnë aktivitetet dhe vendimmarrjen e Kryetarit të Komunës, mbledhjet dhe vendimmarrjen e Kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative, takimet publike, takimet konsultative për projekte, planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të Komunës, përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare, përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje dhe të tjera.